

K Ë R K E S Ë

PËR SHPREHJE INTERSI PËR TË KANDIDUAR NË POZICIONIN VAKANT
TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Drejtuar : KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

TIRANË

Të nderuar zonja/zotërinj të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

Pasi u njoha me njoftimin tuaj për paraqitjen e shprehjes së interesit për të aplikuar për pozicionin vakant të Prokurorit të Përgjithshëm, më lejoni t'ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë parasysh kandidaturën time.

Unë quhem Fatjona Memçaj, aktualisht kryej detyrën e Prokurores së Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë. Jam nxitur për të aplikuar në vendin vakant të Prokurorit të Përgjithshëm nisur nga përvoja ime e gjatë si prokuror dhe nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues, vlerësuar maksimalisht për korrektësinë dhe ushtrimin e çdo detyre të ngarkuar me dinjitet dhe në respekt të etikës sociale dhe profesionale.

Kam studiuar për shumë vite ligj, kam mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në vitin 1999 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2002 në profilin prokuror me rezultate maksimale. Falë bursës Chevening të ofruar nga ambasada britanike në Tiranë kam arritur të përfundoj studimet Master of Law (LLM) në vitin 2008 në Universitetin e Londrës Lindore dhe pas disa vitesh studimi kam përfunduar studimet e doktoraturës në Universitetin e Middlesex të Londrës (part-time) me bursë të ofruar nga vetë universiteti.

Me mbarimin e studimeve të vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës jam dekretuar si Prokuror në stazh pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në tetor të vitit 2001 dhe me përfundimin e ciklit të plotë të studimeve në Shkollën e Magjistraturës në tetor 2002 jam dekretuar Prokuror pranë kësaj prokurorie, detyrë që e kam mbajtur deri në fund të vitit 2008. Kam punuar në seksione të ndryshme të kësaj prokurorie, por pjesën më të madhe të viteve i kam kaluar si pjesë e Task-Forcës së parë kundër krimit në ekonomi dhe korrupsionit të krijuar në prokurorinë shqiptare, drejtuar nga prokurori z. Llambi Bako. Si pjesë e kësaj Task-Force jam ndër prokurorët e parë që kanë aplikuar metodën speciale të hetimit, që sapo ishte parashikuar në Kodin e Procedurës Penale të bashkëpunim me policinë e shtetit.

Në fund të vitit 2007 jam emëruar në Institucionin e Presidentit të Republikës si Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit Ligjor dhe më pas Drejtor i Drejtorisë



Memçaj

Juridike e Koordinimt Ligjor, njësia më e madhe organizative e administratës së këtij institucioni, detyrë të cilën e kam mbajtur deri më datë 11 Janar 2013.

Si pjesë e administratës publike i jam nënshtruar vlerësimeve periodike nga eprori i drejtpërdrejtë dhe jam vlerësuar me vlerësimin maksimal që mund të marrë një nënpunës civil, që është "Shumë Mirë". Më datë 11 Janar 2013 jam dorëhequr me vullnetin tim nga kjo detyrë duke u emëruar Drejtore e Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm. E kam ushtruar këtë detyrë për tetë muaj, ku nga Qershori deri më 1 Shtator të vitit 2013 kam qënë e komanduar. Gjatë kësaj kohe kam kryer me korrektësi detyrat e ngarkuara nga ligji, veçanërisht jam angazhuar në proceset e raportimit të Prokurorisë në kuadër të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, për këtë kam marrë pjesë dhe në takimet ndërinstitucionale brenda dhe jashtë Shqipërisë. Gjithashtu kam qënë pjesë e grupit të punës për reformën në drejtësinë penale, që funksiononte në vitin 2013 pranë Ministrisë së Drejtësisë, grup që asistoj dhe nga misioni OPDAT.

Nga Shtatori i vitit 2013 deri më sot kryej detyrën e Prokurorit të Prokurorisë së Apelit, Tiranë. Jam vlerësuar "Shumë Mirë" nga titullari i institucionit për gjatë gjithë kohës që kam ushtruar këtë detyrë. Me vendimin nr.16, datë 3.5.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit jam konfirmuar në detyrë me vlerësimin për aftësi profesionale të "nivelit të lartë".

Gjatë gjithë këtyre viteve kam punuar gjithashtu si lektor (part-time) i së drejtës, në universitete shtetërore e private, si ekspert i trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës nga viti 2010, ku jam trajnuar dhe si ekspert i ekspertëve. Kam qënë gjithashtu anëtare e Bordit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, Bordit të Mbikqyrjes së Ekzekutimit të Vendimit të Dënimeve Penale, si pjesë e funksionit tim si drejtor juridik, Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës dhe aktualisht jam anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Gjatë gjithë karrierës sime jam përpjekur dhe besoj ia kam arritur të kryej detyrën time me profesionalizëm, nder dhe dinjitet duke respektuar liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe interesin publik.

Duke besuar se do të merret në konsideratë kërkesa ime dhe duke ju falenderuar paraprakisht për kohën e angazhimit tuaj,

Me respekt,
Fatjona Memçaj



Tiranë, me 26.4.2019

